



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF  
PRISTINA



AD/GJTHPR/31/21

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga z.F. G., në çështjen disiplinore ndaj gjyqtarit K. K., bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 31.08.2021 merr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga z.F. G., ndaj gjyqtarit K. K., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykatë – Kryetarja e Gjykatës znj.Albina Shabani Rama me datë 04.08.2021 përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe me datë 02.08.2021 drejtpërdrejtë nga pala ka pranuar ankesën e z.F. G. për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit K. K..

Parashtruesi i ankesës z.F. G. në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka parashtruar ankesë ndaj gjyqtarit K. K. për mos zbatim dhe shpërfillje të aktgjykimit A.nr.1974/17 si dhe për sjellje jo të denjë në raport me palën.

Sipas pretendimeve të palës ankuese gjyqtari K. K. në çështjen administrative ku palë ka qenë parashtruesi i ankesës ka vepruar në kundërshtim me ligjin për konfliktin administrativ duke mos zbatuar ligjin dhe ka caktuar seancën fillestare për çështjen tani të gjykuar në vend se ta zbatojë ligjin dhe aktgjykimin, duke nxjerrë aktgjykim të kundërligjshëm. Pala pretendon se pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit A.nr.1974/17 të datës 09.09.2020 me anë të parashtruesit i'u ka drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative për heshtje administrative. Sipas pretendimeve të tij kjo parashtruesi në vend se të procedohet me një aktgjykim meritor konsiderohet si padi e re nga Gjykata. Përpos dyshimit të palës për shkelje ligjore nga ana e gjyqtarit, i njëjti është ankuar edhe në sjelljet e gjyqtarit respektivisht për shkak të trajtimit jo të duhur të palës në procedurë. Ka theksuar se gjyqtari ka qenë i pa drejtë ndaj palës duke e kërcënuar dhe shantazhuar në seancat gjyqësore pa asnjë arsye, me kërcënim të dënimit me gjobë deri në 1000€ ose me kanosje me burgim deri në gjashtë muaj nëse flet në seancë dhe në seancën e fundit me kërcënim me largim nga seanca në prani të përfaqësuesit të autorizuar.

Në ankesën disiplinore të palës F. G., ka dhënë përgjigje gjyqtari K. K. i cili sa i përket pretendimeve ankimore ka theksuar se këto janë pretendime absolutisht të pavërteta, të trilluara dhe në kundërshtim me autorizimet si gjyqtar. Palës ankuese, gjatë seancës së fundit, joformalisht i është tërhequr vërejtja që të sillet mirë gjatë seancës, gjë që ai sipas gjyqtarit nuk e ka bërë. Ka theksuar se në asnjë rast të vetëm nuk e ka përmendur as dënimin me gjobë dhe as dënimin me burgim, por se në përputhje me Ligjin i është tërhequr vërejtja që të sillet mirë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese dhe pas vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit, ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për t'i vërtetuar dyshimet për shkelje disiplinore.

Autoriteti i kësaj Gjykate, bazuar nga faktet e çështjes, ka konstatuar se sa i përket pretendimeve për shkelje ligjore, të njëjtat nuk janë vërtetuar pasi që në aspektin e çështjes së trajtimit të procedurës gjyqësore dhe vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve, gjyqtari i çështjes vepron në kuadër të autorizimeve ligjore dhe për mënyrën e trajtimit të rastit vendos bazuar në ligjet procedurale. Po ashtu edhe për mënyrën e vendosjes së çështjes gjyqtari vepron konform ligjit dhe për shkeljet eventuale procedurale palës i garantohet e drejta në shfrytëzimin e mjeteve juridike, për të cilat gjyqtari nuk mund t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore, përderisa të mos vërtetohet se gjyqtari veprimet e kundërligjshme t'i ketë marrë me qëllim. Në rastin konkret fakti se është marrë një vendim i caktuar nuk nënkupton se gjyqtari ka kryer veprim i cili përbën shkelje disiplinore në përputhje me shkeljet e parapara me nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Po ashtu as pretendimet për sjellje jo adekuate të gjyqtarit respektivisht mos trajtim të pabarabartë të palëve në procedurë nuk janë vërtetuar. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se gjyqtari ka marrë ndonjë veprim i cili është në kundërshtim me kufizimet nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.2 dhe pika 2.15 e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, lidhur me parashtesën e ushtruar, në bazë të dhënave të përshkruara më lartë, Autoriteti i kësaj Gjykate nuk ka gjetur bazë të arsyeshme për të vendosur se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar KGJK-së kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
AD/GJTHPR/31/21, më datë 31.08.2021

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë